



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 20.4.2016, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

Procesverbal

**i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe
Grupit Punues të Komisionit për Legjislacion**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaku, Alma Lama dhe Jelena Bontiq, si dhe nga Grupi Punues i Komisionit për Legjislacion: Armend Zemaj dhe Agim Aliu.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e MAP-së, OSBE-së, KDI-së dhe Avokatit të Popullit, ZPRK.

Nga Stafi Mbështetës i Komisioneve: Drita Morina, Mirjeta Heta, Visar Krasniqi dhe Bardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Rishqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Rishqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Zenun Pajaziti, i njoftoi të pranishmit, se Komisioni ka ftuar anëtarët e Komisionit për Legjislacion, që së bashku të sqarojnë vërejtjet e Komisionit të tyre, në raportin me rekomandime për Kuvendin për P/ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Armend Zemaj, tha se vërejtjet e Komisionit për Legjislacion janë dhënë në seancën e Kuvendit gjatë shqyrtimit të dytë të P/ligjit, mbi bazë të të cilave vërejtje Kuvendi ka nxjerrë vendim që P/ligji të rishqyrtohet nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Komisioni për Legjislacion dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime për shqyrtim të tretë në seancë plenare.

Vërejtjet e Komisionit janë në pjesë të caktuara të P/ligjit: te përkufizimet, parimet, te konkretizimi i disa dispozitave, mungesa e standardeve në hartimin e tekstit të P/ligjit, mënyra se si zhvillohet procedura në shkallë të parë dhe të dytë, afatet, mungesa e interpretimeve ligjore. Lidhur me këtë, ai propozoi që të ftohen një grup ekspertësh nga fusha e caktuar dhe të mbahet një debat për rregullimin e mangësive të tekstit të P/ligjit dhe për procedurën e mëtejme të vendos Komisioni Funkcional, vërejtjet e sipërshënuara janë shkelje kushtetuese.

Sadri Ferati, tha se Komisioni ka pasur një partneritet me të gjitha institucionet dhe grupet e interesit për të analizuar çdo propozim, vërejtje apo ndryshim. Grupi Punues me përjashtim të pjesës së përkufizimeve të cilat jemi pajtuar që të mos inkorporohen në tekst, me arsyen se janë të vendosura në tekstin e P/ligjit, vërejtje të tjera nuk ka pasur dhe kushdo që ka propozime të reja të deklarohen.

Alma Lama, pyeti pse është dashur të hartohet një tekst i P/ligjit? Kemi cekur edhe gjatë procedurave të shqyrtimit të P/ligjit, që ligji në fuqi ka mundur të amendamentohet, megjithatë po që se dëshirojmë që P/ligji të jetë një ligj i implementueshëm duhet të mbahet një debat më i gjerë me grup ekspertësh dhe Komisionin për Legjislacion.

Xhevahire Izmaku, pyeti cilat janë mundësitë që P/ligji të rregullohet për lexim të tretë, kur të gjitha mjetet për shqyrtim, analizë dhe propozime të tjera janë shterur?

Zenun Pajaziti, kërkoi nga përfaqësuesit e MAP-së, që të gjitha vërejtjet e sipërshënuara të analizohen, të shqyrtohen dhe të prezantohen në takimin e ardhshëm.

Suzana Gashi, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, tha se involvimi i Avokatit të popullit në këtë fazë mund të jetë konflikt interesi për institucionin e Avokatit të Popullit. Ajo e njoftoi Komisionin, se Avokati i Popullit ka vërejtje në përmbajtjen e tekstit të P/ligjit, te parimet, krijimi i institucioneve të reja, akti real, kontrata administrative, si dhe formulimet juridike të cilat janë në kundërshtim me parimet juridike.

Zenun Pajaziti, kërkoi nga përfaqësuesja e Avokatit të Popullit që të sjellin në Komision propozimet konkrete.

Përfundim: Komisioni vendosi që administrata e dy komisioneve t'i radhis të gjitha propozimet konkrete, nëse ka, dhe t'i prezantojë në takimin e radhës së Komisionit.

3. Të ndryshme

ZenunPajaziti, njoftoi Komisionin për konferencën e organizuar nga OSBE, e cila do të mbahet më 27 prill 2016.

Alma Lama, kërkoi që në debate deputetët të ftohen sipas përfaqësimit politik, gjithashtu në Grupet Punuese të mos zbatohen standarde të dyfishta, kjo në kontekst të formimit të Grupit Punues nga Komisioni për Plotësim-Ndryshimin e Ligjit për RTK-në.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

ZenunPajaziti

Kryetari i Komisionit,
